



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.87, Datë 19.05.2020

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK,  
PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 402, SERIA P18, TË MIRATUAR ME  
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 83, DATË 06.04.2018, PËR PRODHIMIN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VOSKOPOJË”, ME KAPACITET TË INSTALUAR  
1970 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, dhe pika 3 të “Rregullores të organizimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.05.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për modifikimin e licencës së shoqërisë “FAVINA 1” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “FAVINA 1” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 650, datë 22.04.2020, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës nr. 402, Seria P18, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018 “Për licencimin e shoqërisë “FAVINA 1” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me kapacitet të instaluar 1970 kW.
- Shoqëria parashtron se kërkesa për modifikimin e licencës së sipërcituar vjen si rezultat i prurjeve të mëdha të lumit të Voskopojës i cili shkakton rritjen e kapacitetit nga 1970 kW në 2400 kW.
- Shoqëria “FAVINA 1” shpk, është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 24.10.2005, me statusin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Në objekt të veprimtarisë së tij kjo shoqëri ka: *Prodhimin e energjisë elektrike nga centralët elektrike ekzistues me kapacitet ekzistues të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.*
- Nga analizimi i të dhënave teknike për HEC-in të përcjellë nga shoqëria “FAVINA 1” shpk, vërehet se, ndryshimi konsiston vetëm në rritjen e kapacitetit të instaluar nga 1970 kW në 2400 kW.
- Aplikimi i shoqërisë “FAVINA 1” shpk, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, gërma “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës : është plotësuar tërësisht.
  - Neni 15, pika 4, gërma “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: është plotësuar tërësisht.
  - Neni 15, pika 4, gërma “c”: Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera: është pa plotësuar. Nga shoqëria nuk janë depozituar në ERE lejet nga institucionet e tjera (Leje mjedisore, Leje e shfrytëzimit të ujit, Pika e lidhjes me rrjetin), të përditësuara me kapacitetin e instaluar të modifikuar sipas rritjes që ka parashtruar shoqëria në këtë kërkesë dhe miratimi nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha)
  - Neni 15, pika 4, gërma “d”: Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi : është e pa plotësuar. Nga ana e shoqërisë nuk është dhënë informacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.
  - Neni 15, pika 4, gërma “e”: Të ketë shlyer pagesat e rregullimit në ERE: është plotësuar tërësisht .
- Për dokumentacionin e konstatuar të munguar , do të njoftohet subjekti që në bazë të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve të percaktuara në rregullore.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

### **Vendosi :**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “FAVINA 1” shpk, për modifikimin e licencës nr. 402, Seria P18, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 83, datë 06.04.2018, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë” si më poshtë:
  - kapaciteti i instaluar nga 1970 kW të bëhet 2400 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**